

20212884519

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË  
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN E  
KORRIDORIT RRUGOR VIII – FAZA I E PROJEKTIT, QË DO TË LIDHET MIDIS  
BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NDËRMARRJES  
PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave nga Marrëveshja e Huasë për financimin e Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, që do të nënshkruhet në mes të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore me vlerë prej 110.000.000 milionë euro, nëse Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nuk i përmbush dhe servison detyrimet e Marrëveshjes së Huasë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë do të përcaktohen me Marrëveshjen e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, që do të lidhet në mes Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore për financimin e Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, si dhe servisimin e huasë, do t'i kryejë Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në kuadër të afateve dhe kushteve të përcaktuara me Marrëveshjen e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 4

Huaja e nenit 1 të këtij ligji ndahet në dy transha. Transha e parë është me vlerë prej 41.700.000 euro, kurse transha e dytë është me vlerë prej 68.300.000 euro.

Norma e interesit është variable dhe përbëhet nga EURIBOR-i gjashtëmujor i zmadhuar për margjinë prej 1%.

Afati i pagesës së dy transheve të huasë është 16 vjet me grejs periudhë të përfshirë prej katër viteve. Të dyja transhet e huasë do të paguhen në 24 këste gysmëvjetoare më datë 15 qershor dhe 15 dhjetor çdo vit. Afati i pagesës së transhes së parë fillon nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga lidhja e marrëveshjes së huasë, ndërsa afati për pagesën a transhes së dytë fillon nga data e parë e përfundimit të vitit të katërt nga dita e qasjes për shfrytëzim të transhes së dytë.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në emër të huamarrësit do të tërheqë nga mjetet e huasë provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% nga vlera e transhës së parë në afat prej shtatë ditëve nga dita e efektivitetit të transhës.

Në afat prej shtatë ditësh nga dita e qasjes për shfrytëzim të transhës së dytë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në emër të huamarrësit do të tërheqë nga mjetet e huasë provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% nga vlera e transhës së dytë.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion prej 0.5% nga huaja në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra për transhën e parë do të fillojë të llogaritet pas 60 ditësh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes sipas nenit 1 të këtij ligji.

Provizioni për mjetet e patërhequra për transhën e dytë do të fillojë të llogaritet pas 60 ditësh nga dita e qajes për shfrytëzim të transhës së dytë.

#### Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji dhe Marrëveshjes së Garancisë, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë.

#### Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve ndaj Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore nga ana e realizuesit të përzgjedhur nga Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore që do t'i realizojë punët kontratuuese të dedikuara për realizimin e Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, i financuar me Marrëveshjen e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, është i liruar nga tatimi i vlerës së shtuar me të drejtë të zbritjes (heqjes) së tatimit paraprak.

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve të kryera ndaj realizuesit të përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore që do t'i realizojë punët kontratuuese të dedikuara për realizim të Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, i financuar me Marrëveshje e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji është i liruar nga tatimi i vlerës së shtuar me të drejtë të zbritjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave i realizuar nga importuesi i përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, i destinuar për Korridorin Rrugor VIII – Faza I e projektit, i financuar me Marrëveshja e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, lirohet nga tatimi i vlerës së shtuar, detyrimet importuese, akciza e emergjentëve dhe tatimi i automjeteve mototrike për makinat për udhëtarë.

Importuesi gjatë importit të të mirave, të liruara në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i parashtron kopje të Marrëveshjes së Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, vërtetim nga Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore se importuesi është përzgjedhur që të kryejë import për qëllime të Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, dhe deklarata se të mirat/mallërat janë të dedikuara për realizimin e Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, i financuar me Marrëveshjen e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji.

Për qarkullimin që është kryer ndaj realizuesit të përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, i cili do t'i realizojë punët kontratuuese të dedikuara për realizimin e Korridorit Rrugor VIII – Faza I e projektit, financuar me Marrëveshjen e Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, me të cilin ai është debitor tatimor në përputhje me nenin 32, pika 4) dhe nenin 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar është liruar nga detyrimi i llogaritjes dhe i pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (titullit) të pranuesit të të mirave ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e shënon edhe emrin e projektit dhe emrin e Marrëveshjes së Huasë sipas nenit 1 të këtij ligji.

#### Neni 7

Të mirat/mallrat që janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 6, paragrafi (3) të këtij ligji, në afat prej tre vitesh nga dita e importit, nuk mund të tjetërsohen, të jepen në shfrytëzim, të jepen hua ose në mënyrë të ndryshme të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese, para se të jenë paguar detyrimet importuese. Të mirat dhe shërbimet nuk mund të lihen peng, me qira ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse mbajtësi i së drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit (1) të këtij neni, synon t'i shfrytëzojë të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 6, paragrafi (3) të këtij ligji për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat ato ishin liruar nga pagimi i detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor tek organi doganor.

Shumën e borxhit doganor sipas paragrafit (2) të këtij neni, organi doganor e përllëgarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve që ishin të plotëfuqishme në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni, shuma e borxhit doganor përllëgaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruar nga pagesa e detyrimeve importuese.

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.